

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1

020.

Alfred
Çapaliku

**PËR NJERËZIT
E PUNËS**

poezi

81H-1

620.

Alfred
Çapaliku



PËR
NJERËZIT
E
PUNËS

poezi

SHKËRTI BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

QYTETI IM

Qyteti im ka ndërtesa me arkitekturë,
vinçat ngado zhurmojnë e ngrihen në lartësi,
punëtorët e NN-së gjithë ditën ngrejnë mure,
si në legjendën e bukur të origjinës së tij.

Këtu, në kohën tonë, në kundërshtim me legjendën
megjithëse orëve të natës muret ngrihen lart,
s'ka asnjë kurban, asnjë vajtim e asnjë shembje,
gratë me kominoshe sjellin tulla e llaç.

Kalojnë pleqtë gazmorë të lagjes aty pari,
(jo vetëm një, si dikur, me shkopin e ngrënë nga
vitet)
pensionistët aksioneve me punë vullnetare
s'thonë veç «puna e mbarë», por vetë mbi skela
ngjiten.

Qyteti im ka ndërtesa me arkitekturë,
vinçat ngado zhurmojnë e ngrihen në lartësi,
s'ka asnjë natë profetike t'ia lëvizë muret,
sfidë nëntëballësh — Bahçallëku i ri!

MARGARITËS¹⁾

Kur muret lëvizën
në ajër çatia,
në pluhur mobiljet
dhe çanta me libra.

Një timbër kumbues
të thirri për ndihmë,
vajtimi i foshnjës
si një cicërimë.

Vure trupin tënd
si urë mes jetës,
guri dot s'e shemb
harkun e buzëqeshjes.

1) Margarita Zefi, pionierja nga Dajçi, për të shpëtuar vajzën e vogël dy vjeçare të fqinjët nga pasojat e tërmetit, sakrifikoi jetën e saj.

DASMË...

Ç'dasmë në Shirq të ri
i bie daulles jeta,
ritmin çekan-mistri
në çadër sjell gërneta.

Dhëndri fare natyrshëm
pozon pak si me turp,
qesh nusja, feksin blicët
të dy rrinë sup më sup.

Dhe është kjo kohë e madhe,
është ky antitërmet,
që dhe ndër rite dasmash
të renë si farë mbjell!

BRENDA NJË ÇASTI

Në takimet midis shokëve të mirë,
mes fjalëve të ngrohta hyn buzëqeshja
dhe brenda një çasti aspak të vështirë
merr nga tjetri gjërat që i do tek vetja.

Brenda çastit në sytë e shokut, shoqes,
sheh peizazhe alpesh, Rivierën e kaltër,
me zhurma makinash, kombajnash, avionësh,
nga bohçet e pishave, te portokallet.

Në largimet midis shokëve të mirë
pas fjalës «mirupafshim» nuk peshon heshtja
dhe brenda këtij çasti pak të vështirë
tjetri merr nga ti gjërat që do tek vetja.

SHOFERI REMZI

I thjeshtë, herolk,
çdo çast është ai,
guxim komunist —
shoferi Remzi.

Nga turni i tretë,
në turnin e parë,
teposhtë, tatëpjetë,
pa njohur orar.

Kufirit ditë-natë
bie fort një bori,
në fushë, në rrafshnaltë
makina e tij.

Thërret ky sinjal
në shi, vapë, erë
porsi në alarm
me dhjetra shoferë.

I thjeshtë, heroik,
në zemra na rri,
veç bujës i ik
shoferi Remzi.

E PËRDITSHME

5⁴⁵. Qyteti i zgjuar,
përbri meje një punëtor
me dy fëmijë në duar.

Nxitoj drejt autobusit urban,
ai drejt kopshtit me drekë,
mbi muskuj peshën e jetës mban.

Fytyra të reja e të zakonshme
çdo orë më flasin për çarjen e bllokadës;
kush tha se dita e punës qenka e lodhshme?

Sfidë çdo rrethimi, dita fillon bukur,
përbri meje ecën i qeshur një punëtor
me dy vogëlushë të lumtur.